

**VENDIM**  
**Nr. 325, datë 2.6.2021**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITETIT  
PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP PËR PROJEKTIMIN,  
NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E  
AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë *Mabco Constructions Sa, Yda Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi, 2A Group sh.p.k.*, si koncesionari për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**